## AKT THEMELIMI

## I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE " GRIALD " SHPK

Une, Gezim Halili, i biri i Bajramit, lindur me 14.9.1964 ne Kukes, banues ne Kukes, lagja 1, pall.7, shk.1, ap. 7, me pasaporte nr. 0269212, mbeshtetur ne nenin 251, shkronja " o", te ligjit nr.7512 date 10.08.1991 " Per shoqerite tregtare", " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire te veprimtarise private dhe privatizimit", krijoj shoqerime tregtare private me pergjegjesi te kufizuar te quajtur " GRIALD " shpk dhe hartoj kete akt themelues si vijon :

### FORMIMI

**NENI 1**

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur " BRIALD " shpk.

Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit shqiptar, ndersa deget qe mund te krijohen do t'i nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega.

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

### VEND QENDRIMI I SHOQERISE

**NENI 2**

Vendqendrimi i shoqerise tregtare private " GRIALD " shpk do te jete ne Kukes, lagja 1, pall.7, shk.1, ap. 7,

Shoqeria do te hape edhe vendqendrime te tjera te dyta, dege, filiale, perfaqesi dhe agjensi, ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

### OBJEKTI I VEPRIMTARIE

**NENI 3**

Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj ne fushen e :

- projektimi, zbatimi ne fushen e ndertimeve civile, ekonomike dhe veshje fasadh, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infrastrukt ure, rikonstruksione godinash civile, mirembajtje, zhvillimi dekori ne mjedise urbane etj.
- prodhimi, perpunimi i materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtimi i tyre. ./.

- magazinimi dhe paisja e panaireve dhe ekspozitave, sherbimeve, reklama dhe marketingu.
- importi dhe eksporti i materialeve te ndertimit, tregtimi i tyre me shumice e pakice.

NENI 4

Perkryerjen e veprimtarise se saj, shoqeria do te hape njesi tregtimi, sherbimi dhe perpunimi dhe do te bashkepunoje me persona fizike dhe juridike, vendas dhe te huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohezgjatja e shoqerise do te jete me nje afat mbi 10 vjet.
Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfaredo lloj shkaku.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali fillestar i shoqerise shpk " GRIALD " eshte 100.000 leke, e cila perbehet nga kuota e ortakut te vetem, themelues te shoqerise.
Kapitali fillestar mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakut.
Kuota e ortakut ne kapital eshte e gjithe e ortakut dhe e pandashme.

NENI 7

Ortaku duhet te beje perpjekje per rritjen e potencialit ekonomik te shoqerise, ta ruaje sekretin e saj dhe te mos demtoje interesat e personave te tjere.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Administrator i shoqerse eshte ortaku i vetem z. Vezim Halili.

NENI 9

Te ardhurat nete te shoqerise i takojme ortakut te vetem themelues te shoqerise.

./.

**NENI 10**

Administratori emeron edhe administratore te tjere te vlerave materiale te shoqerise. Ai ka te drejte te caktoje financiare, likujdatore per problemet e shoqerise, si edhe te pajtoje persona te tjere si ortake.

Financieri ncjerr rregullisht tregtuesit financiare tremujore, 6 mujore dhe vjetore per aktivitetin e kryer te shoqerise .

~~[illegible]~~

**NENI 11**

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme, me tekstin per rrethin e saj.

**NENI 12**

Konfliktet qe mund te lindin midis paleve do te gjykohen ne gjykaten e rrethit Tirane, sipas statutit te shoqerise, kontrates se lidhur me palet dhe ne zbatim te legjislacionit shqiptar.

**NENI 13**

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 " per krijimin e e shoqerise tregtare.

**NENI 14**

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku themelues .

ORTAKU THEMELUES I SHPK
GEZIM HALILI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. REP. 6020
N. kol. 680

**V E R T E T I M**

Sot ne Tirane, me date 23.08.1997 ne zyren e noterise u paraqit Gezim Halili me , madhor , me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa siper, jashte kesaj zyre, ka hartuar nje akt themelimi per krijimin e shpk " GRIALD " dhe pasi nenshkroi rregullisht , une noteri e vertetoj sipas ligjit.

N O T E R E : FATMARA SHEHU

[illegible] pullas u pagua 50 lek.

# S T A T U T

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " GRIALD "

Une, Nezim Halili, i biri i Bajramit, lindur me 14.9.1964 ne Kukes, banues ne Kukes, lagja 1, pall.7, shk.1, ap. 7, me pasaporte nr. 0269212, vendosa te miratoj statutin e shoqerise tregtare private " GRIALD " SHPK si vijon:

## KREU PARE

## EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA , KAPITALI , OBJEKTI

NENI 1

Shoqeria emerttohet " GRIALD " SHPK .

NENI 2

Selia e shoqerise tregtare private "GRIALD " shpk do te jete ne Kukes, lagja 1, pall.7, shk.1, ap. 7.

NENI 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet. Shoqeria e fiton personalitetin e vet nga momenti i rregjistrimit ne regjistrin tregtar prane gjykates se rrethit Tirane.

NENI 4

Kapital themeltar i shoqerise do te jete 100.000 leke, prone e ortakut te vetem. Kapitali fillestar i shoqerise mund te ndryshohet sipas vendimit teortakut te vetem themelues te shoqerise.

NENI 5

Objekti i veprimtarie eshte :

- Projektimi, zbatimi ne fushen e ndertimeve civile, ekonomike veshje fasadh, banesa, hotele, objekte kulti, rruge, infraskture, rikonstruksi ne civile, mirembajtje, zhvillimi dekori ne mjedise urbane etj.
- prodhimi, perpunimi i materialeve te ndertimit, transportimi dhe tregtimi i tyre.
- magazinimi dhe shperndarja e materialeve te ndertimit.
- è organizimi dhe paisja e panaireve dhe ekspozitave , sherbimeve, reklama dhe marketingu
- importi dhe eksporti i materialeve te ndertimit, tregtimi i tyre me shumice e pakice.

./.